




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**AKT PËRCJELLËS**

Për:	Menaxherin e prokurimit: “Komuna Mitrovicë”	Kopje:	Paneli Shqyrtues – OSHP Nr. 121/17
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues 		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën “Shënjestimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës”, me nr. të Prokurimit: 642/17/010/521		
Përgjigjeje në ankesë:	OE- “RSM Company” sh.p.k.		
Datë	08.05.2017.		


Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesën e parashtruar nga OE: “RSM Company” sh.p.k, kundër AK- Komuna Mitrovicë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shënjestimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës” me nr. të Prokurimit: 642/17/010/521

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

- 1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
- 1x1 Autoriteti Kontraktues.
- 1x1 Operatorit ekonomik ankues.

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: “Shënjestimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës”, me nr. të Prokurimit: 642/17/010/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovicës.

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES - TEKNIK

	28.04.2017	29.04.2017	08.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit	Data e autorizimit të eksp.	Data e fillimit të ekspertizës	Data e dorëzimit të raportit

### N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 21.04.2017, OSHP, ka pranuar ankesën me nr. 121/17, e parashtruar nga OE: **“RSM Company” sh.p.k – nga Prishtina**, kundër AK – **Komuna e Mitrovicës** lidhur me aktivitetin të prokurimit **“Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës”** me nr. të Prokurimit: **642/17/010/521**.

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna e Mitrovicës**.

### N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues **“RSM Company” sh.p.k.**

#### Pikat e Ankesës nga OE **“RSM Company” sh.p.k** **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:**

Autoriteti kontraktues ka bërë shkeljen e dispozitave të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe Dosjes se Tenderit:

Neni 59- Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahassimi I Tenderëve, Nenpika 4 Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në është në përputhshmeri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontrates dhe në dosjen e tenderit.

Neni 60-Kriteret për dhenien e kontrates, Nenpika 1.1 Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontraten publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me të ulët.

Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët - Pika 1 -Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni, dhe; Pika 4 - Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.

Neni 68 - Gjendja ekonomike dhe financiare - Nenpika 1.3 kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilanci e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose Nenpika 1.4. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim.

#### Neni 70-Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: **“Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës”**, me nr. të Prokurimit: **642/17/010/521**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna e Mitrovicës**.



Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t'u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe (ii) të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet e certifikimit. Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së.

**Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:**

Neni 59- Ekzaminimi. Vlersimi dhe Krahاسimi I Tenderëve. Nenpika 4 Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundërshtim te ketij neni, pasi qe kompania e shpallur fituese Malsija, ne dokumentacionin e saj tenderues nuk ka paraqitur deshmi te mjaftueshme qe tregojne qe i permbush te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit.

Neni 60-Kriteret per dhenien e kontrates-Nenpika 1.1 Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni, pasi qe ka shpallur fitues nje kompani e cila nuk ka qene e pergjegjshme, pasi qe ne dosje te tenderit ka paraqitur nje Certificate te 3M te skaduar ne Mars 2017, ndërsa dorezimi i tenderit ka qene me date 03.04.2017. Poashtu kompania e shpallur fituese ka paraqitur Kopjen e Licences se Auditorit te panoterizuar, sic eshte kerkuar ne dosje te tenderit, pra ka paraqitur vetem kopje te atij dokumenti.

Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, Pika 1 dhe Pika 4 Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni, pasi qe fillimisht eshte dashur te kerkoje nje sqarim nga kompania e shpallur fituese, per disa nga cmimet e ofruara, te cilat jane jashte cdo logjike, dhe te cilat nuk perkojne me cmimet e tregut.

Shembull i Pozicioni 4.1 - Pragjet rrugore prej gome për ngadalësimin e shpejtësis (policë të shtrir) me dimensione 500(mm) të gjera gjatësi 900(mm) dhe lartësi 50 (mm), kompania e shpallur fituese ka ofertuar me cmim prej 1.80 Euro/m' (me TVSH), kurse cmimi me ilire i tregut per kete pozicion eshte ne vlere prej 33.00 Euro/m'

Shembull 2 - Pozicioni 6.1 , 6.2, 6.3 – Kompania e shpallur fituese, ne keto pozicione ka ofertuar me cmim prej 2.50 euro/cope, kurse kostoja e furnizimit me e lira e mundshme eshte 19.50 Euro / cope, duke perfshire tabelen, folien, shtyllen, pa perfshire hapjen e gropes dhe betonimin.

Shembull 3 - Pozicioni 6.4 - Kompania fituese per kete pozicion ka ofertuar me cmim prej 2.80 Euro/cope, kurse nje table 600x900 mm blehet me cmimin 8.5 euro/cope ne Itali, kurse kostoja e folies(Adezivit) se kualitetit te kerkuar per nje table me kete dimension kushton 5.94 euro qe gjithsejt del me cmimin 14.4 euro, cope. Poashtu kesaj kostoje i shtohet edhe shtylla qe kushton 7 euro/3m, qe gjithsej kostoja del 21.40 Euro/cope, pa perfshire hapjen e gropes dhe betonimin.

Shembulli 4 - Pozicioni 6.5 - Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 3.00 Euro/m2, ndërsa kostoja e kesaj table eshte : 31.00 Euro, pa perfshire kapriata, grupa dhe betonimi i saj.

Shembulli 5 – Pozicioni 6.8 - Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 0.10 Euro/cope, qe eshte jashte cdo logjike, pasi qe nje table e tille kushton 16.00 Euro pa transport dhe

Shembulli 6 - Pozicioni 7.1 - Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 0.10 Euro/cope, kurse cmimi

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: “Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës”, me nr. të Prokurimit: 642/17/010/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovicës.”



i furnizimit me i lire i mundshem eshte 33.00 Euro/cope, pa montim, shtylle, grope dhe betonim.

Shembulli 7 - Pozicioni 8.1 - Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 0.20 Euro/m', kurse cmimi i furnizimit eshte 18.00 Euro/m", pa perfshire transportin dhe montimin.

Shembulli 8 - Pozicioni 8.2 - Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 0.80 Euro/m', kurse sipas cmimit te tregut, ky produkt kushton 20.00 Euro/m".

Shembulli 9 - Pozicioni 10.1 - Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 0.80 Euro/cope, kurse vetem galvanizimi i ketyre shtyllave kushton 2.80 Euro/cope, ndersa komplet nje shtylle antipark arrin nje vlere prej 8.00 Euro/cope.

Pra marre ne teresi, kostoja totale e ketij projekti me sasite e parapara ne dosje te tenderit, arrin mbi 50 % te vleres se ofertes se OE Malsija, e cila me ato cmime ka per qellim demtim te tregut ne fushen e sinjalistikes.

Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni dhe te udhezimit te KRPP-se per rregullat e tendereve jo-normalisht te ulet, pasi qe oferta e OE Malsija, i ploteson te 3 kriteret esenciale per tu shpallur tender jo normalisht i ulet. Ne kete rast Autoriteti Kontraktues nuk i ka bere fare llogaritjet, dhe ka vepruar ne kundershtrim me nenin 61 te LPP, pra eshte dashur te kerkohen sqarime lidhur me cmimet e ofruara nga OE Malsija, ne menyre qe te arsyetohen cmimet abnormale te uleta te ofertuara nga OE Malsija.

Neni 68 - Gjendja ekonomike dhe financiare, Pika 1.3 dhe 1.4 Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni pasi qe: Ne dosje te tenderit eshte kerkuar: a.Auditimi i pasqyrave financiare nga një Compani e licencuar ose nje auditor i licencuar për vitet (2014.2015,2016) - Licenca e Auditorit e Noterizuar, kurse kompania e shpallur fituese, ka paraqitur Auditimet por nuk ka paraqitur Licencen e Noterizuar te Auditorit, por vetem nje kopje te ketij dokumenti. Kurse ne kemi paraqitur Auditimet dhe licencat e auditorit te noterizuara ashtu sic eshte kerkuar ne dosje te tenderit.

Neni 70- Standardet për Sigurimin e Cilësisë Autoriteti kontraktues ka bere shkelje te ketij neni pasi qe ne dosje te tenderit eshte kerkuar:

b.Të bashkangjesë QERTIFIKATË “3M” Ndërkombetare në emër të Companisë (Origjinal ose copje e noterizuar).- Kurse kompania e shpallur fituese ka paraqitur kete certifikate po me afat te skaduar, ku afatin e skadimit e ka patur ne muajin Mars 2017, kurse dorezimi i tenderit ka qene me date (03.04.2s)1 7. Edhe ne kemi pasur certifikaten paraprake me afat skadimi te njejte, por me kohe kemi bere aplikimin per tu pajisur me Certifikaten e re me afat.

#### Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	07.03.2017
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Punë/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	24.03.2017
Afati i parapare per hapje te ofertave.....	24.03.2017
Data e njoftimit për dhënie të kontrates.....	06.04.2017

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: “Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës”, me nr. të Prokurimit: 642/17/010/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovicës.



## Kriteret për vlerësim:

### III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

a) Deklarata në betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri sikur është cekur në nenin 65 të LPP 05/L-068 b) Një vërtetim nga Autoriteti kompetent gjyqësor i vendit të themeluesit të tenderuesit (Gjykata THEMELORE e vendit të themeluesit të O.E.) se themeluesi i O.E. nuk ka pengesa lidhur me kërkesat nga FTD, nëni 6 pika 6.3 të dosjes së tenderit (jo më datë më të vjetër se 3 muaj (tre) nga data e fundit të dorëzimit të tenderit.. Origjinal ose kopje e noterizuar-. Vetëm për fituesin e Tenderit. c) Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është në vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në 3 (tremujorin e fundit të vitit para Publikimit të njoftimit për kontratë. Origjinal ose kopje e noterizuar-. Vetëm për fituesin e Tenderit.

### III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

a). Certifikata e regjistrimit të biznesit e lëshuar nga MTI, ose regjistrimin e biznesit nga vendi i themelimit të ofertuesit (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë); b) Certifikata e regjistrimit të TVSH-së (për Kompanitë Kosovare); c) Certifikata e regjistrimit

#### Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a) Një deklaratë në betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit.... Origjinal b) Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit (vetëm për OE fitues). c) Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vetëm për OE fitues). Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë, pika b, c do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit A.K. ka ndër mend ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti tenderi në fjalë do të refuzohet

### III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

a). Certifikata e regjistrimit të biznesit e lëshuar nga MTI, ose regjistrimin e biznesit nga vendi i themelimit të ofertuesit (në qoftë se kompania fituese e tenderit është e regjistruar jashtë Kosovës, duhet të regjistrojë përfaqësinë në Kosovë); b) Certifikata e regjistrimit të TVSH-së (për Kompanitë Kosovare); c) Certifikata e regjistrimit të numrit fiskal (për Kompanitë Kosovare)

#### Dëshmia e kërkuar dokumentare:

- a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit- (kopje).
- b. Certifikata e TVSH-së (kopje).
- c. Certifikatën me numër fiskal (kopje)

### III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Qarkullimi jo më pak se 660,000.00 € tri vitet e fundit :2014,2015 dhe 2016.

#### Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Auditimi i pasqyrave financiare nga një Kompani e licencuar ose një auditor i licencuar për vitet (2014,2015,2016) - Licenca e Auditorit e Noterizuar.

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: “Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës”, me nr. të Prokurimit: 642/17/010/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovicës.



### III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

a.Kontrata në vlerë jo më pakë se 495,000.00 € te punëve te ekzekutuara në lëmin e sinjalizimit HORIZONTAL dhe VERTIKAL në tri vitet e fundit, për operatorin ekonomik ose grupin e operatorëve ekonomik b.QERUFUKAT “3M” Ndërkomtare në emër të Companisë. c.QERTIFIKATË ISO 9001/2018 Ndërkomtare. d.QERTIFIKATË ISO 14001/2004 Ndërkomtare në emër të Companisë e.QERTIFIKAT ISO/IEC 270001/2013. Ndërkomtare në emër të Companisë f.QERTIFIKATË K16 160 për produkte në emër të Companisë. g.Mostra për Sinalim HORIZONTAL dhe VERTIKAL .

#### Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a.Një listë të kontratave për punë të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar trevjeçare (2014,2015,2016) , duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e punëve. b.Të bashkangjesë QERTIFIKATË “3M” Ndërkomtare në emër të Companisë (Original ose copje e noterizuar).- c.Të bashkangjesë QERTIFIKATË ISO 9001/2008 Ndërkomtare. (Original ose copje e noterizuar).- d.Të bashkangjesë QERTIFIKATË ISO 14001/2004 Ndërkomtare në emër të Companisë. (Original ose copje e noterizuar).- e.Të bashkangjesë QERTIFIKAT ISO/IEC 27001/2013 Ndërkomtare në emër të Companisë. (Original ose copje e noterizuar).- f.Të bashkangjesë QERTIFIKATË K16 160 për produkte në emër të Companisë. (Original ose copje e noterizuar).- g.Të sjellë Mostra për Sinjalizim HORIZONTAL dhe VERTIKAL.

#### Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €
1.	N.P.G “Malsija”	Gurakoc	282,003.00 €
2.	“RSM Company”	Prishtinë	525,483.50 €
3.	“Sinjal” sh.p.k	Ferizaj	338,253.00€

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 24.03.2017, konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë tri (3) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.

#### Komisioni vlerësues pranë AK:

##### Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Avdi MAZLIUKAJ,
- - Anëtar i komisionit - Mehmet BAJRAMI,
- - Anëtar i komisionit – Fisnik IBRAHIMI

Data e mbarimit të vlerësimit: .....05.04.2017

Data e nënshkrimit të raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....05.04.2017

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: “Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës”, me nr. të Prokurimit: 642/17/010/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovicës.’



## Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni vlerësues, pas ekzaminimit vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, propozon për dhënjën e kontrates kompanisë : NPG MALSIJA, si tenderues teknikisht i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët prej 282,003.00€.

Komisioni vlerësimit konstaton se raportin e vlerësimit se OE SINJAL sh.p.k, NUK i plotëson kërkesat teknike të kërkuar në dosjen e tenderit, ndërsa OE RSM COMPANY, është i përgjegjshëm por ka tejkaluar buxhetin e paraparë për këtë projekt.

## Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - (N. 306)

**Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:**

### Sqarimi 1.

Autoriteti Kontraktues - “Komuna Mitrovicë”, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, kontratë publike me vlerë të mesme, operatori ekonomik ankues: RSM COMPANY sh.p.k, ka parashtruar ankesë me dt.21.04.2017 në OSHP, kundër Njoftimit për dhënie të kontratës të dt. 06.04.2017, me pretendimet ankimore se AK-ja ka NUK ka respektuar nenin 59,60,61,68 dhe 70 të LPP-së.

- Në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga ana e OE ankues, sa i përket çertifikatës 3M të ofruar nga OE i rekomanduar për kontrat,
- Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor për faktin se në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrat pika 9.1 dhe 9.2 Autoriteti kontraktues ka kërkuar: “Çertifikat 3M ndërkomtare në emër të kompanisë” ndërsa OE i rekomanduar për kontrat ka ofruar çertifikat me afat skedues, e cila ishte valide deri në muajin Mars 2017, ndërsa dorëzimi i ofertave është bërë në muajin Prill 2017, duke u bazuar në këtë Eksperti shqyrtues vlerëson se ky OE i rekomanduar për kontrat është i papërgjegjshëm në këtë pikë.
- Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket licences së auditoret të jetë e noterizuar,
- Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë për faktin se në dosjen e tenderit pika 8.1 dhe 8.2, është kërkuar: licenca e auditoret e noterizuar, ndërsa OE i rekomanduar për kontrat ka ofruar kopjen e licences të auditorit të pa-noterizuar.
- Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket nenit 61 të LPP-së, ku OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontrat ka ofruar çmime jo reale të tregut të cilat janë jo-normalisht të ulët,
- Eksperti shqyrtues duke u bazuar në pretendimin ankimor si dhe në pozicionet e cekura në lidhje me çmimet jo-normalisht të ulët në lidhje me ofertën financiare të OE fitues, vlerëson se Autoriteti kontraktues NUK ka vepruar në harmoni me nenin 61, pika 1 dhe

Raporti i ekspertit teknik për lëndën: “Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës”, me nr. të Prokurimit: 642/17/010/521, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Mitrovicës.

2 e LPP-së, sepse oferta financiare e OE fitues, ka ofruar çmime për pozicionet e ofertës financiare që duken të jenë jo-normalisht të ulët. Poashtu AK-ja gjatë përgjigjes me shkrim në lidhje me kërkesën e OE ankues për shqyrtim të vendimit të AK-së pranon se të gjithë OE ofertës kanë ofruar çmime jo-normalisht të ulët për disa pozicione, që nënkupton se AK-ja ka qenë në dijeni se çmimet NUK janë në harmoni me çmimet e tregut.

**Eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontaktues NUK ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së, gjatë ekzaminimit vlerësimit dhe krahasimit të ofertave në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit pasi që OE i rekomanduar për kontrat NUK të gjitha kërkesat e parashtruar në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrat në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit.**

#### **Mendimi i ekspertit:**

- Eksperti shqyrtues, bazuar në sqarimet e cekura në raport mendojnë që Autoriteti Kontraktues – **Komuna e Mitrovicës**, për aktivitetin e prokurimit: **“Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në qytetin e Mitrovicës”**, me nr. të Prokurimit: **642/17/010/521**, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që të anulohet vendimi i AK-së, njoftimin për dhënje të kontratës dhe lënda të kthehet në **RI-TENDERIM**, nëse edhe më tutje ka interes AK-ja për këtë aktivitet të prokurimit. Ndërsa ankesa e OE **“RSM COMPANY” sh.p.k.** të aprovohet si pjesërisht e bazuar.